



UDHËZIME për zbatimin e drejtë të ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Dhjetor, 2015.

Botues: Communication for Social Development - CSD

Përpunimi dhe Printimi: Communication for Social Development - CSD

Dizajn grafik: Aleksandar Velić

Tirazhi: 500

Graçanicë, 2015.

Copyright © 2015. Communication for Social Development – CSD

Ky udhëzim, i dedikuar për zbatimin efektiv të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e qeverisjes lokale të Republikës së Kosovës është i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nëpërmjet programit të saj Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT). Pikëpamjet e shprehura në këtë Udhëzues/Doracak jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Përmbajtje:

1. Rreth projektit
2. Shkurtesat
3. Rreth Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT)
4. Rreth “Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë” - CSD
5. Rreth Ligjit për përdorimin e gjuhëve
6. Kompetencat e Zyrës së komisionerit për gjuhët
7. Detyrimet e institucioneve rreth zbatimit të Ligjit
8. Struktura komunale
 - 8.1 Kuvendi i komunës
 - 8.2 Kabineti i Kryetarit të Komunës
 - 8.3 Drejtoria e Administratës dhe personelit
 - 8.4 Drejtoria e Shëndetësisë
 - 8.5 Drejtoria për çështje sociale
 - 8.6 Drejtoria për Arsim
 - 8.7 Sektori për Kulturë
 - 8.8 Sektori për Rini dhe Sport
 - 8.9 Drejtoria e Financave
 - 8.10 Sektori për ekonomi dhe zhvillim
 - 8.11 Sektori për zhvillimin ekonomik
 - 8.12 Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
 - 8.13 Drejtoria për bujqësi dhe pylltari
 - 8.14 Shërbime publike
 - 8.15 Inspekcioni
9. Rekomandimet për institucionet qendrore
10. Rekomandimet për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët
11. Rekomandimet për bashkësinë ndërkombëtare
12. Gjuha ime, e drejta ime, mundësia ime

Rreth projektit

USAID-i nëpërmjet programit të “Avancojmë Kosovën së Bashku” (AKT) në partneritet me OJQ “Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë” - CSD janë duke zbatuar projektin "Mbështetje përpjekjeve të Komisionerit për gjuhët për të promovuar përdorimin e gjuhëve zyrtare në 12 komuna partnere të programit të USAID-it të “Avancojmë Kosovën së Bashku” (Gjilan/Gnjilane, Graçanicë/Gračanica, Istog/Istok, Klinë/Klina, Klokot/Klokot, Novobërdë/Novo Brdo, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Partesh/Parteš, Ranillug/Ranilug, Shtërpçë/Štrpce dhe Vushtrri/Vučitrn). Projekti synon të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në përfaqësimin e nevojave dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, si dhe bashkëpunimit me përfaqësues të institucioneve. Nëpërmjet të njohurive dhe përvojës ne do mund t'i nxjerrim në pah dështimet dhe pasojat për shkak të zbatimit të dobët të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë, në një shoqëri që aspiron të jetë demokratike.

Në kuadër të projektit, partneri ynë OJQ “Komunikimi për zhvillim e shoqërisë” – CSD ka organizuar dymbëdhjetë (12) debate në dymbëdhjetë (12) komuna të përzgjedhura, të cilat janë ndjekur nga përfaqësues të qeverisjeve lokale, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të medieve, pjesëtarë të respektuar dhe aktiv të komuniteteve, si dhe një numër i kënaqshëm i të rinjve dhe grave. Pas këtyre debateve, CSD-ja ka formuar një ekip të veprimit të përbërë nga një përfaqësues i qeverisjes lokale dhe një përfaqësues i të shoqërisë civile nga secila komunë partnere. Ekipi i veprimit i ndihmuar dhe mbështetur nga ekspertë, zyrtarë të Zyrës së Komisionerit për gjuhët, ekipit të CSD-së dhe ekipit të USAID/AKT kanë marrë pjesë në krijimin e *Udhëzimit* për zbatimin e duhur të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në qeverisjet lokale. Ky *Udhëzim* është një mjet i veçantë dhe një instrument që do të përdoret çdo ditë në të gjitha drejtoritë komunale, dhe në këtë mënyrë do të përmirësohet cilësia e përdorimit të gjuhëve. Gjatë hartimit të këtij *Udhëzimi*, CSD-ja ka punuar në mënyrë aktive së bashku me autoritetet lokale dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të komunave partnere, përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për gjuhët në Qeverinë e Kosovës dhe përfaqësues të ekipit të USAID/AKT.

Ky dokument paraqet një version të veçantë të udhëzimit për përdorimin dhe zbatimin e duhur të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Dokumenti përmes kapitujve tematikë merret me fusha të ndryshme të përdorimit zyrtar të gjuhëve, duke i theksuar rregullat përkatëse kryesore. Ky dokument merret kryesisht me tema që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare në praktikë, por është e rëndësishme të theksohet se shumica e artikujve gjithashtu kanë të bëjë me përdorimin zyrtar të gjuhëve të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Kosovë. Përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare mund të arrihet vetëm nëse të gjitha palët që marrin pjesë në komunikim i njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre. Informimi i të gjithë pjesëmarrësve në procesin e realizimit të së drejtës për përdorimin e gjuhëve të tyre krijon kushte për respektim të ndërsjellë të identitetit gjuhësor dhe kulturor, promovon tolerancë në mesin e qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme amtare dhe mbështet bazat e shtetit të së drejtës. Ky *Udhëzim* ka për qëllim të shërbejë kryesisht si udhërrëfyes për ata që punojnë në qeverisjet lokale në drejtimin e aspekteve të ndryshme të komunikimit në gjuhët e komuniteteve jo shumicë.

Shpresojmë se të gjitha përpjekjet dhe puna që kemi bërë do ta përmirësojnë nivelin e komunikimit dhe ta sigurojnë mirëkuptimin më të mirë midis të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të mundësojnë realizimin më të lehtë të një të drejte themelore të njeriut, të drejtën për të përdorur gjuhën amtare.

Shkurtesat

CSD	Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë (Komunikacija za razvoj društva)
USAID	Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar
AKT	Të avancojmë Kosovën së bashku
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
MF	Ministria e Financave
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
ZKGJ	Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Rreth Avancojmë Kosovën së Bashku (AKT)

Programi i USAID-it Avancojmë Kosovën së Bashku (Advancing Kosovo Together, AKT) është dizajnuar me qëllim të përmirësoje bashkëpunimin dhe ndërveprimin konstruktiv ndëretnik, veçanërisht në mes komuniteteve shumicë dhe pakicë që është kusht më rëndësi për stabilitetin në rajon. Programi ka një qasje specifike ndaj integritit të popullatës pakicë në institucionet dhe shoqërinë Kosovare, përmes partneritetit me komunat dhe partnerëve të tjerë Qeveritar në mënyrë që të përmirësohet pjesëmarrja e komuniteteve jo-shumicë.

Programi në veçanti do të merret me përmirësimin e kushteve të cilat do ti mundësojnë etniteteve pakicë që në mënyrë aktive të kyçen në punën e Institucioneve Kosovare e në të njëjtën kohë të mbrojnë dhe ruajnë trashëgiminë e tyre kulturore.

Programi synon ketë ta realizoj përmes:

- Përmirësimin të komunikimit mes komuniteteve shumicë dhe pakicë; dhe Qeverisë së Kosovës dhe komuniteteve pakicë përmes projekteve infrastrukturore të një shkalle më të vogël dhe iniciativave tjera që vijnë nga komunitetet;
- Përmirësimin të mundësive ekonomike në komunat e zgjedhura përmes trajnimeve, hulumtimit të tregut dhe granteve për biznese të vogla;
- Rritjes së efikasitetit dhe kapaciteteve të komunave të zgjedhura për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike pikësëpari në fushën e menaxhimit financiar dhe planifikimit;
- Ndërtimit të kapaciteteve të organizatave vendore duke fuqizuar lidërsipin lokal ndëretnik për të zbatuar objektivat e sipërpermendura.

Avancojmë Kosovën së Bashku do të jetë në partneritet të drejtpërdrejtë me 16 komuna përfshirë gjashtë (6) komuna me popullatë shumicë Serbe në jug të Kosovës: Graçanicë, Kllokot, Novobërdë, Partesh, Ranillug, dhe Shtërpçë; dhe gjashtë (6) komuna me popullatë shumicë Shqiptare: Gjilan, Istog, Klinë, Obiliq, Pejë dhe Vushtrri. Programi do të zbatohet edhe në katër komunat në veri: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

Programi do të përfshijë më shumë se 600,000 banorë të Kosovës përfshirë këtu edhe 146,000 banorë nga komunitetet pakicë. AKT do të implementohet nga Prilli i vitit 2014 deri në Prill të vitit 2017.

Rreth CSD-së

OJQ Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë (CSD) me seli në Graçanicë është organizatë lokale e pavarur, jo-fitimprurëse, dhe jopartiake e themeluar në vitin 2001 me objektivin kryesor të promovojë dhe të punojë në ndërtimin e shoqërisë civile, zhvillimin e të rinjve, të avokojë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, integrimin e grupeve të marginalizuara në shoqëri, ndërlidhjen në mes të institucioneve lokale dhe qytetarisë lokale si dhe të promovojë procesin e kthimit dhe dialogut. Përfituesit e drejtpërdrejtë të veprimeve të CSD-së në terren janë komunitetetjo shumicë, më saktësisht serbët dhe romët, të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet e CSD-së kanë për qëllim forcimin e sektorit të OJQ-ve, duke siguruar mbështetje teknike, duke informuar dhe edukuar qytetarët dhe duke punuar vazhdimisht për promovimin dhe përfaqësimin e shoqërisë civile në publik. CSD gjithashtu angazhohet në mbështetjen e krijimit të rrjeteve të OJQ-ve dhe në koordinimin e organizatave jo-qeveritare në projekte të përbashkëta. CSD ofron shërbime të tilla si informacion publik, produksione i radio dhe video materialeve, promovimin e dialogut dhe procesin e pajtimit në mes të komuniteteve në Kosovë, gjithashtu ofron informata për personat e zhvendosur dhe ofron programe të edukimit për të rinjtë.

CSD ka një tendencë të fortë që shoqëria civile të pranohet si një partner konstruktiv strategjik në komunitetin përkatës, me qëllim të zgjidhjes së problemeve. CSD është duke punuar shumë edhe në kuptimin që sektori civil së bashku me vendimmarrësit të jetë një pjesëmarrës i rëndësishëm në të gjitha proceset aktuale shoqëro-politike.

Duke punuar në të gjithë Kosovën, kemi zhvilluar një model që ka për qëllim të inkurajojë të rinjtë në gjetjen e mënyrave të veçanta nëpërmjet të cilave do të mund të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Duke u ballafaquar me sfida të ndryshme dhe duke kërkuar, në mënyrë aktive, zgjidhjet më të mira, kryesisht për të rinjtë, ne kemi zhvilluar elementë të rinj programorë të projekteve tona.

Vëmendje të veçantë i kushtojmë zhvillimit të marrëdhënieve me komunitetin lokal, i cili bazohet në të kuptuarit e atij komuniteti, të gjitha specifikat e tij, por edhe në përfshirjen e të gjitha palëve përkatëse dhe të interesuara të atij komuniteti (liderët, përfaqësuesit e pushtetit lokal, sektorit civil).

Realizimi i një bashkëpunimi të këtillë midis të gjithë pjesëmarrësve, ku pushteti dhe përgjegjësitë në vendimmarrje janë të ndara, dërgon drejt një tranzicioni të suksesshëm që do të krijojë një shoqëri të hapur, shumënike dhe moderne demokratike.

Rreth Ligjit për përdorimin e gjuhëve

Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve hyri në fuqi në vitin 2007 me qëllim për të siguruar respektimin e identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe të krijojë një mjedis ku të gjitha komunitetet mund të shprehin dhe të ruajnë identitetin e tyre gjuhësor.

Nenet 1-3

Ofrojnë të drejta gjuhësore të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, barazi gjuhësore, promovimin e të gjitha gjuhëve, përcaktojnë gjuhët zyrtare në nivel qendror dhe lokal, gjuhët në përdorim zyrtar dhe përcaktojnë përqindjen në bazë të të cilës një gjuhë mund të bëhet gjuhë zyrtare në nivel lokal.

Përdorimi i gjuhëve në institucionet qendrore

Nenet 4-6

Ofrojnë përdorimin e gjuhëve në punën e institucioneve qendrore. Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në komunikim, në mbledhjet dhe takimet e institucioneve, në takime publike, në dokumentet zyrtare, në emrat zyrtarë të institucioneve, etj. Këto nene sigurojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës gjatë punës së Kuvendit, komiteteve të ndryshme dhe gjatë miratimit të ligjeve dhe akteve normative në gjuhët zyrtare.

Përdorimi i gjuhëve në institucionet komunale

Nenet 7-10

Këto nene përcaktojnë përdorimin e gjuhëve në nivel lokal; në përputhje me to, çdo takim, çdo dokument, rregullore dhe dekret komunalë duhet të nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse. Gjuhët kanë status të barabartë dhe duhet të sigurohen shërbime të përkthimit nga një gjuhë në tjetrën, nëse një gjë e tillë kërkohet.

Ofrojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës në përdorim zyrtarë si dhe të drejtat e qytetarëve për të kërkuar shërbime në këto gjuhë, në qoftë se gjuha e tyre është njëra prej gjuhëve në përdorim zyrtarë. Për më tepër, këto nene shpjegojnë se si duhet të jenë të shkruar emrat e institucioneve, shenjat, emrat e komunave, qyteteve, fshatrave, rrugëve, etj.

MAPL-ja nëpërmjet Udhëzimit Administrativ nr. 2011/02 mbi përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve ka shpjeguar këto nene në detaje.

Përdorimi i gjuhës në ndërmarrjet publike

Neni 11

Siguron që të gjitha ndërmarrjet, si ato publike si ato në pronësi shoqërore duhet të respektojnë barazinë gjuhësore. Çdo person duhet të jetë në gjendje të jetë i informuar dhe të komunikojë në cilëndo gjuhë zyrtare.

Përdorimi i gjuhës në procedurat gjyqësore

Nenet 12-18

Ofrojnë barazinë e gjuhëve zyrtare në të gjitha procedurat gjyqësore, të drejtën e çdo personi që gjatë këtyre procedurave të përdorin gjuhën e tyre të zgjedhur. Të gjitha procedurat, dokumentet, informatat dhe shkresat duhet të jenë në gjuhët zyrtare. Çdo person, gjuha e të cilit/ës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar, ka të drejtë të komunikojë, të kërkojë shërbime dhe të japë përgjigje në gjuhën e tij/saj amtare. Institucionet për zbatimin e ligjit, gjykatat, burgjet, etj, janë të detyruar të ofrojnë ndihmë për të gjithë ata persona për sa i përket përkthimit dhe komunikimit.

Përdorimi i gjuhës në institucionet arsimore

Nenet 19-24

Sigurojnë që gjuhët në të cilat zhvillohet procesi mësimor në institucionet arsimore publike janë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës dhe të Ligjeve për arsimin. Çdo person ka të drejtë të arsimohet në gjuhën e tij/saj amtare. Institucionet arsimore janë të detyruara të ndërmarrin të gjitha veprimet në përputhje me Ligjet për arsimin dhe ligje të tjera përkatëse. Gjuhët zyrtare në Kosovë, janë gjuhët kryesore në të cilat zhvillohet procesi mësimor në universitetet publike.

Përdorimi i gjuhës në media

Nenet 25-26

Sigurojnë që çdo person ka të drejtë të themelojë medie në gjuhën të cilën ai/ajo e zgjedh në përputhje me ligjin në fuqi.

Përdorimi i gjuhës së operatorëve publikë gjatë transmetimit të programit është i rregulluar me Ligjin për media.

Emrat personal

Neni 27

Siguron të drejtën e regjistrimit të emrit personal në regjistrat publikë. Çdo individ ka të drejtë të regjistrojë emrin e tij/saj në formën origjinale, në varësi të gjuhës dhe traditës së tij/saj.

Liria gjuhësore

Nenet 28-30

Sigurojnë të drejtën e secilit për të themeluar, administruar dhe mbajtur në gjuhën e tyre subjekte juridike të tilla si shoqata kulturore, organizata, biznese etj. Gjithashtu, në sferën private, kompanitë mund të komunikojnë dhe të ofrojnë shërbime në gjuhën që ata/ato zgjedhin. Megjithatë, nëse aktivitetet e këtyre ndërmarrjeve, gjuha e të cilëve nuk është njëra nga gjuhët zyrtare, mund të dëmtojë, interesin publik legjitim, siç janë rendi dhe siguria publike, shëndeti, etj, institucionet e Kosovës kërkojnë një përdorim shtesë të gjuhëve zyrtare.

Në kompanitë që ofrojnë shërbime publike, aplikohet parimi i barazisë së gjuhëve zyrtare.

Zbatimi

Neni 31

Siguron që Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera do të miratojnë masat për promovimin e përdorimit dhe statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe për të siguruar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare.

Zyrës së Komisionerit për Gjuhët

Zyra e komisionerit për gjuhët është formuar në muajin prill të vitit 2012, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në bazë të Rregullores Nr.07/2012.

Me qëllim të avancimit të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Qeveria e Kosovës në vitin 2011 ka formuar Grupin punues për reformimin e Komisionit për gjuhët. Projektin e reformës e ka udhëhequr Zyra e Kryeministrit/Zyra për çështje të komuniteteve. Si rezultat i punës së këtij grupi punues, është sjellë Rregullorja 07/2012 për Zyrën e komisionerit për gjuhët, në bazë të së cilës janë formuar dy-(2) mekanizma mbështetës – Bordi për politika gjuhësore dhe Rrjeti i politikave të gjuhëve.

Mandati i Zyrës së Komisionerit për Gjuhët

Zyra e komisionerit për gjuhët ushtron kompetencat e përcaktuara me Ligjin dhe:

- Monitoron përputhshmërinë me Ligjin nga ana e çdo institucioni nën juridiksionin e saj;
- Merr të gjitha masat e nevojshme nën autoritetin e vet, përfshirë ato përmes ndërmjetësimit, për të siguruar përputhshmërinë me Ligjin nga të gjitha institucionet nën juridiksionin e saj. Shqyrton dhe bën rekomandime përkitazi me rregulloret apo udhëzimet administrative në kuadër të Ligjit, sa i përket përputhshmërisë dhe konsistencës së cilitdo akt legjislativ, rregullore apo udhëzimi administrativ me Ligjin;
- Kryen hetime, qoftë me iniciativën e vet apo në bazë të ankesave të bëra nga një person juridik apo fizik sa i përket dështimit të ndonjë institucioni nën juridiksionin e saj për respektimin e Ligjit apo me ndonjë akt tjetër ligjor sa i përket statusit apo përdorimit të gjuhëve zyrtare apo gjuhëve tjera të komuniteteve gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës;
- Ofron, sipas nevojës, këshilla apo ndihmë për publikun në lidhje me të drejtat e tyre sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- Ofron, sipas nevojës, këshilla apo ndihmë për institucionet nën juridiksionin e saj sa i përket obligimeve të tyre sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- Ndihton qeverinë në zhvillimin e programeve të vetëdijesimit publik apo i zhvillon vet ato si dhe aktivitete të rregullta kontaktuese me publikun për t'i informuar ata rreth obligimet dhe të drejtat e publikut në kuadër të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;

Me qëllim të realizimit të kompetencave të tyre, Zyra ka autoritetin dhe autorizimet të:

- Kërkojë, të ketë qasje në dosje dhe të shqyrtojë dosje të institucioneve, ndërmarrjeve apo organizatave nën juridiksionin e vet;
- Kërkojë që institucionet dhe stafi i tyre të bashkëpunojnë me Zyrën duke i lejuar Zyrës qasje në ambientet e tyre dhe qasje në informatat e nevojshme, përfshirë kopjet e dosjeve të plota apo të pjesshme dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së Zyrës me përjashtim të informatave dhe dosjeve të klasifikuara;
- Thërrasë cilindo person apo dëshmitar për qëllim të marrjes së dëshmimeve me shkrim apo me gojë që nevojiten për kryerjen e hetimeve;

- Mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për personat që duhet të jenë të pranishëm në Zyrë apo të udhëtojnë për të dhënë informata, të dhëna apo dëshmi për qëllime të hetimit;
- Si mjet i fundit, kur rekomandimet e zyrës për korrigjim dhe përmirësim apo kompensim nuk janë realizuar nga institucionet përkatëse, të lëshojë apo vë sanksione siç përshkruhen nga Udhëzimi Administrativ në fuqi i cili aplikohet në përcaktimin e sanksioneve administrative për shkeljen e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve;
- Sipas nevojës, në rast se një nuk iu përmbahet apo refuzon t’iu përmbahet kërkesave të Zyrës apo e pengon Zyrën në kryerjen e detyrave të saj, apo kur natyra e shkeljes lejon një masë të tillë, Zyra mund të nisë procedura juridike apo disiplinore përmes autoritet përkatës ndaj personit apo organizatës përgjegjës/e për shkeljen.

Detyrimet e institucioneve rreth zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve

- Institucionet janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të zbatuar plotësisht Ligjin për përdorimin e gjuhëve për të mundësuar ushtrimin e të drejtave gjuhësore në përputhje me Ligjin;
- Institucionet janë të obliguara të sigurojnë dokumentacionin publik dhe informata në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal;
- Institucionet e ndryshme duhet të respektojnë barazinë gjuhësore në të gjitha dokumentet publike të cilat i nxjerrin dhe publikojnë;
- Materialet mbështetëse që shfrytëzohen për komunikim ndërinstitutional duhet të jenë në gjuhët zyrtare;
- Shenjat topografike duhet të shënohen në të gjitha gjuhët zyrtare, duke respektuar barazinë gjuhësore;
- Në të gjitha institucionet nën juridiksionin e Zyrës së komisionerit për gjuhët duhet të harmonizohen faqet zyrtare të internetit në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha informatat e institucioneve duhet të vendosen në të njëjtën kohë në të gjitha gjuhët zyrtare.

Kuvendi i Komunës

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit

Kuvendi zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në pajtim me dispozitat e Ligjit për zgjedhjet lokale.

Kuvendi I komunës është I obliguar që të miratojë një Rregullore të detajuar mbi përdorimin e gjuhëve brenda territorit të komunës përkatëse, siç e parashikuar me Ligjin për përdorimin e gjuhëve;

Kuvendi I komunës dhe kryetari kanë të drejtë të sjellin akte ligjore dhe ne përputhje me përgjegjësitë përkatëse ndërmarrin masa në kuptim të realizimit të të njëjtave. Të gjitha aktet e nxjerra nga komuna duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Komunës mund të miratojë akte brenda kompetencave të tij.

Aktet e nxjerra nga kuvendi i komunës vlejnë për territorin e komunës që ka miratuar këto akte: Këto akte janë si në vijim:

- a) Statuti i komunës;
- b) Rregullorja e punës;
- c) Rregulloret komunale dhe
- d) Çdo dokument tjetër ligjor që është i nevojshëm për funksionimin efikas të Komunës.

Statuti i komunës mund të miratohet dhe ndryshohet me vendim për miratimin apo për ndryshimin e Statutit, të së paku 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.

Numri i anëtarëve të Kuvendit të Komunës duhet të jetë në proporcion me numrin e qytetarëve në komunë. Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të marrë pjesë plotësisht në punën e Kuvendit. Kuvendi Komunal do të sigurojë ofrimin e këtyre mundësive në statutin e saj dhe rregullat e procedurës apo Rregulloren e punës.

Kuvendi i komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Njoftimet dhe materialet për mbledhje duhet të respektojnë Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve.

Procesverbali mbahet në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij dhe miratohet në takimin e ardhshëm në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Rekomandime

- Kuvendi Komunal do të duhej, që në përputhje me mundësitë që ka, gjatë planifikimit të buxhetit -- për shkak të mungesës së një përkthyesi – të fus në rend të ditës edhe linjën buxhetore për përkthim, e gjitha kjo në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Kuvendi Komunal gjatë hartimit të buxhetit mund të propozojë një linjë buxhetore të fondeve shtesë për aftësim profesional të përkthyesve.

Udhëzime

- Çdo akt ligjor, rregullore ose ndonjë dokument tjetër ligjor përpara hyrjes në fuqi duhet të përkthehet në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse. Gjatë ushtrimit të punëve të përditshme të këshilltarëve komunalë, takimeve dhe seancave të Kuvendit të Komunës duhet të sigurohet përkthim adekuat në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.
- Njoftimet dhe materialet për seancat e Kuvendit duhet të publikohen në të njëjtën kohë në dyja (gjitha) gjuhët zyrtare të komunës.
- Procesverbalet e seancave, para miratimit, duhet të përkthehen dhe tu shpërndahen këshilltarëve në të dyja (gjitha) gjuhët zyrtare para miratimit.
- Të sigurohet që secili akt ligjor, rregullore apo çdo dokument tjetër ligjor i njerr nga Kuvendi Komunal të jetë i njëjtë në të dyja (gjitha) gjuhët zyrtare pa hapësira për interpretim të ndryshëm apo keqinterpretim.

Kabineti i Kryetarit të Komunës

- **Zyra për marrëdhënie me publikun**
- **Zyra komunale për komunitete dhe kthim**
- **Zyra komunale për të drejtat e njeriut**

Përgjegjësitë e Zyrës për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun

- merr pjesë në takimet e drejtpërdrejta të kryetarit të komunës, si brenda ashtu edhe jashtë komunës;
- merr pjesë në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve, komiteteve dhe ato të Kuvendit të Komunës;
- ka përgjegjësinë të koordinojë çështjet lidhur me shtypin lokal dhe atë ndërkombëtar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e kryetarit të komunës, drejtorëve të departamenteve përkatëse dhe zyrave të tjera;
- bashkërendon zhvillimin dhe zbatimin e përgjegjësive komunale për të komunikuar me publikun;
- ofron informata rreth politikave të zhvillimit të komunës;
- monitoron zbatimin e Strategjisë për komunikim me qytetarët/et dhe administron kodin e sjelljes së zyrtarëve për komunikim me publikun, në mënyrë që ata/ato t'i përmbahen standardeve të larta etike;
- siguron transparencë dhe qasje të hapur në lidhje me punën e drejtorëve dhe të administratës komunale, institucioneve shkollore dhe atyre shëndetësore si dhe ndërmarrjeve të tjera publike, duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medie;
- informon publikun për vendimet e miratuara nga Kuvendi, përmes konferencave dhe lëshimit të komunikatave për shtyp;
- mban lidhje të afërta me shtypin komunal dhe mediet elektronike në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me autoritete dhe organet komunale;
- punon në nxjerrjen e një gazete të brendshme komunale "Buletini Informativ";
- siguron informata brenda-përbrenda komunës dhe është në bashkëpunim të vazhdueshëm me drejtorët e drejtorive dhe zyrtarët të cilët janë të punësuar në Drejtorinë e administratës;
- përcjell punën e përfaqësuesve komunalë dhe regjistron të gjitha deklaratat e përfaqësuesve komunalë që u janë dhënë medie;
- përgatit fletëpalosje, broshura, buletine informative, etj.;
- përzgjedhë dhe arkivon artikuj të gazetave që i referohen punës së komunës përkatëse;

Përgjegjësitë e Zyrës për komunitete dhe kthim

Zyra për komunitete dhe kthim

- është përgjegjëse për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve;
- siguron që komunitetet të kenë të drejta të barabarta sa i përket shërbimeve publike në territorin e komunës përkatëse;
- përgatit raporte duke përshkruar në detaje punët e kryera e që janë përgjegjësi ekskluzive e Zyrës për komunitete dhe kthim;
- nën-vrojtimin e drejtpërdrejtë të Kryetarit të komunës ndihmon në përgatitjen dhe hartimin e Strategjisë komunale për kthim;
- bën mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave të ndërlidhura me kthimin në komunën përkatëse (personat e riatdhesuar);

- në bashkëpunim me Kryetarin e komunës ndihmon në funksionimin më të mirë të strukturave ekzistuese;
- ushtron punë administrative të cilat janë të nevojshme për mbështetjen e strukturave ekzistuese për kthim, siç janë: caktimi i mbledhjeve, njoftimi i pjesëmarrësve, përgatitja dhe shpërndarja e rendit të ditës në gjuhët zyrtare dhe përgatitjen e procesverbalit;
- merr pjesë në mbledhjet e komiteteve ekzistuese (Komitetit për komunitete, Komitetit për ndërmjetësim dhe Komitetit për politikë dhe financa) dhe në forume të tjera në të cilët diskutohen dhe/apo janë në rend të ditës çështje të ndërlidhura me komunitetet.

Përgjegjësitë e Zyrës për të drejtat e njeriut

Zyra për të drejtat e njeriut

- ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në nivel komunal, së bashku me tre zyrtarë të tjerë të përfshirë brenda-përbrenda Komunës;
- monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut: mundësitë e barabarta, parimin e mosdiskriminimit, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me paaftësi, të drejtat e komuniteteve, të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- ofron këshilla në lidhje me përpilimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve të miratuara nga Kuvendi Komunal në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe legjislacionin vendor;
- monitoron aktivitetin e Komunës dhe në të njëjtën kohë e këshillon Kryetarin e komunës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut;
- bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat komunale, OJQ-të në rrafshin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut;
- bashkëpunon, me qëllim të realizimit të përgjegjësive me institucione dhe agjenci të ndryshme duke përfshirë edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.

Rekomandime:

- Të forcohet roli i personit kontaktues nga rrjeti për politikë gjuhësore, ai/ajo ka përgjegjësinë dhe mundësinë e adresimit të çështjeve gjuhësore brenda komunës;
- Të krijohen mundësitë për bashkëpunim dhe shkëmbim të praktikave të mira dhe resurseve mes komunave për efekt të përmirësimit të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare;
- Gjatë krijimit të strategjisë për komunitete dhe kthim të përfshihet pjesa që adreson dhe/apo i referohet përmirësimit të cilësisë së përdorimit të ligjit për gjuhët;
- Emrat e rrugëve brenda territorit administrativ të komunave përkatëse, të cilat nuk mbajnë emra të personaliteteve të përkthehen në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjithë emrat e institucioneve publike dhe kompanive private që kanë të bëjnë me të mirën publike duhet që në mënyrë të dukshme të theksojnë apo vendosin emrin dhe kompetencat në gjuhët zyrtare.

Udhëzime:

Zyra për marrëdhënie me publikun

- Në komunikim me shtypin vendor, duhet që i gjithë informacioni të botohet njëkohësisht në gjuhët zyrtare;

- Duhet të ketë një qasje adekuate dhe e njëkohshme publike lidhur me punën e drejtorive, në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha informatat dhe dokumentet për shtyp duhet të jenë identike, pa ndonjë mundësi për një interpretim të ndryshëm, dhe të botohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare;
- Në gjuhët zyrtare dhe në të njëjtën kohë të informohet publiku për të gjitha vendimet e Kuvendit Komunal;
- "Buletini" komunalë nuk mund të publikohet vetëm në njëren gjuhë, para nxjerrjes duhet të jetë në mënyrë identike i përkthyer në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të sigurohet që informacioni i brendshëm dhe bashkëpunimi mes drejtorive dhe nëpunësve civilë është në përputhje me gjuhën e tyre amtare (në njëren nga gjuhët zyrtare);
- Çdo deklaratë e Kryetarit të Komunës dhe e zyrtarëve komunalë duhet të jetë e përkthyer në mënyrë adekuate dhe në dispozicion në kohë reale në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha buletinet, broshurat dhe materialet e tjera informative duhet të publikohen në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse. Nuk duhet të publikohen në vetëm njëren gjuhë derisa nuk është gati edhe në gjuhën/ët tjera, por të publikohen në të njëjtën kohë, në gjuhët zyrtare për informacion më të mirë dhe më të përshtatshëm për qytetarët.
- Të gjitha lajmet që kanë të bëjnë me komunën duhet të përkthehen në gjuhët zyrtare para arkivimit.

Zyra për komunitete dhe kthim

- Çdo shkelje e Ligjit për përdorimin e gjuhëve të lajmërohet tek zyra e caktuar pranë qeverisë lokale dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët.
- Çdo raport i ZK-së të jetë në dispozicion në gjuhët zyrtare para publikimit dhe arkivimit.
- Të gjitha informatat që kanë të bëjnë me kthimin dhe me personat e riatdhesuar duhet të vihen në dispozicion në gjuhët zyrtare në të njëjtën kohë.
- Të gjitha punët administrative të Zyrës për komunitete siç janë: caktimi i orarit të takimeve, informimi i pjesëmarrësve, përgatitja dhe shpërndarja e rendit të ditës duhet të respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve.
- Të gjitha informatat e mbledhura në takimet që kanë të bëjnë me kthimin dhe komunitetet duhet të sigurohen në gjuhët zyrtare dhe të informohet grupi i synuar në komunën përkatëse.

Zyra për të drejtat e njeriut

- E drejta në gjuhë është një e drejtë themelore e njeriut dhe këtu me këtë zyrë ka detyrim të raportojë çdo dështim të evidentuar së pari Kryetarit të komunës dhe më pas edhe Zyrës së Komisionerit për Gjuhët dhe t'i bëj thirrje të gjithë faktorëve përkatës për respektimin e ligjit për gjuhët.
- Të paralajmërohet Kryetari i komunës dhe të gjithë drejtorët e departamenteve përkatëse mbi rëndësinë e publikimit adekuat dhe të njëkohshëm të dokumenteve publike, vendimeve, thirrjeve dhe formave në gjuhët zyrtare.
- Të mos lejohet publikimi i asnjë dokumenti zyrtar, ftese, vendimi dhe informate në vetëm një gjuhë, derisa është në përkthim në gjuhën/t tjetër/a zyrtare, e gjithë kjo për të shmangur humbjen e mundësive të barabarta për të gjitha komunitetet në komunën përkatëse.

Drejtoria e Administratës

Roli dhe kompetencat e drejtorisë

- Shërbimet që kanë të bëjnë me punët e Kuvendit dhe të ekzekutivit, siç janë: të gjitha punët rreth përgatitjes së materialeve të mbledhjeve të Kuvendit, të komiteteve dhe të Këshillit të Drejtorëve, duke filluar nga përpilimi i ftesës dhe i vendimeve të cilat dalin nga mbledhjet, lekturimin dhe përkthimin e materialeve në gjuhët zyrtare;
- Shërbimet administrative lidhur me prokurimin – procedurat e prokurimit, bazuar në Ligjin mbi prokurimin;
- Shërbimet që kanë të bëjnë me fushën e logjistikës dhe funksionimin e saj, ku përfshihet menaxhimi i parkut të automjeteve, kujdesi për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare etj.;
- Regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga depoja e Komunës;
- Bazuar në Udhëzimin administrativ të MAPL-së, shërbimet përfshijnë: komunikimin korrekt me qytetarë, vënien e kërkesave në dispozicion të qytetarëve, t'i këshillojë dhe t'u japë ndihmë juridike – administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave, regjistrimi i të gjitha kërkesave të palëve, raportimi për lëndët e kryera gjatë secilit muaj, arkivimi i lëndës arkivore dhe kujdesi për ruajtjen e saj;
- Kujdesi për shërbimet postare, shërbimet e sigurimit dhe mirëmbajtës së objekteve;
- Mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informatike etj.
- Në shërbimet administrative që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bëjnë pjesë:
- Shërbimet e gjendjes civile që përfshijnë statusin civil të qytetarëve, të regjistrimit të: të lindurve, të kurorëzuarve, të vdekurve dhe lëshimin e certifikatave që dëshmojnë gjendjen civile të qytetarit, duke përfshirë edhe certifikatën e vendbanimit, si dhe ndërrimin e emrit personal;
- Vërtetimin e dokumenteve në bazë të dokumenteve origjinale;
- Të gjitha punët tjera në bazë të kompetencave të deleguara nga pushteti qendror.

Në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarë kryhen edhe punët që kanë të bëjnë me organizimin e qytetarëve në lagje, fshatra, zyra të vendit dhe në bashkësi lokale.

Rekomandime:

- Të sigurohet njësi/zyra për përkthime me kapacitete profesionale në mënyrë që përkthimi të jetë adekuat në gjuhët zyrtare;
- Në përputhje me kërkesat statutores të themelohet një zyrë për orientim të qytetarëve/shërbime për qytetarët (për ato komuna që akoma nuk i kanë formuar) – kjo zyrë do të ketë në përbërjen e saj pjesëtarë të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën përkatëse;
- Në mënyrë të përshtatshme të stimulohen përkthyesit e komunës të cilët ushtrojnë punën e tyre përtej standardeve, sikur që edhe zyrtarë të tjerë të cilët ofrojnë shërbime për qytetarët në të gjitha gjuhët zyrtare pa përkthyes;
- Në një vend të dukshëm të të gjitha institucioneve publike në komunë të vendosen informatat në lidhje me mundësitë e ankesave në qoftë se qytetarët mendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre gjuhësore;
- Komisioni i ankesave duhet të marrë obligim për të shqyrtuar ankesat në lidhje me përdorimin e gjuhëve në nivel lokal dhe për t'i bërë rekomandime një departamenti të caktuar;

- Të krijohen kushte për përmirësimin e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në lidhje me ofrimin e shërbimeve për qytetarët në gjuhët zyrtare.
- Të sigurohet kategorizim adekuat për përkthyesit dhe gjithashtu pajisjet/mjetet ndihmëse për punën e tyre.

Udhëzime:

- Të vendoset një tabelë orientuese, në të gjitha gjuhët zyrtare, në një vend të dukshëm të të gjitha institucioneve publike në komunë;
- Çdo drejtori dhe zyrë duhet të ketë një mbishkrim, në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse, mbi funksionin dhe juridiksionin e së njëjtës;
- Të gjitha udhëzimet dhe informacionet duhet të shtypen në gjuhët zyrtare;
- Broshurat, informacionet, njoftimet, shpalljet për vende të lira të punës dhe çdo dokument tjetër me interes publik duhet të botohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare të komunës;
- Në çdo kërkesë të qytetarëve qoftë me gojë, me shkrim, nëpërmjet telefonit, apo në ndonjë mënyrë tjetër drejtuar administratës lokale të kthehet përgjigje në gjuhën e qytetarit (në njërën prej gjuhëve zyrtare);
- Shërbimet që kanë të bëjnë me çështjet e kuvendit të komunës duhet të jetë të përkthyer në mënyrë identike në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse, pa mundësinë e një interpretimi të ndryshëm;
- Të gjitha materialet nga seancat e Kuvendit, komisioneve dhe të bordit të drejtorëve para arkivimit dhe përcjelljes për përdorim të mëtejshëm duhet të jenë identike në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Çdo masë disiplinore duhet të dorëzohet në gjuhën amtare të zyrtarit/es, përveç nëse kërkohet ndryshe, ndërsa e njëjta duhet të përkthehet në gjuhën(t) zyrtare për efekt të arkivimit;
- Çdo mundësi e trajnimit dhe aftësimin profesional të nëpunësve civilë duhet tu ofrohet zyrtarëve të të gjitha komuniteteve dhe duhet të ketë përkthim adekuat në gjuhën e tyre;
- Çdo evidencë, regjistrim dhe dosje duhet të ketë materialin në të gjitha gjuhët zyrtare dhe si e tillë të arkivohet dhe të përcillet për përdorim të mëtejshëm;
- Këshill-dhënia qytetarëve automatikisht duhet të jetë në gjuhën e tyre amtare në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Ndihma juridike për qytetarët rreth plotësimin të kërkesave dhe formave duhet të ofrohet në gjuhën amtare të qytetarit/es, në të njëjtën kohë kërkesat dhe format duhet të jenë në gjuhën amtare të qytetarit/es në qoftë se ajo gjuhë është një nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Drejtoria për Shëndetësi

Roli dhe kompetencat e drejtorisë

- Hartimi i strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor, që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor dhe imunizimin;
- Sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardit të specifikuar nga ministria përkatëse;
- Kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, përmes aktiviteteve të Qendrës për Punë Sociale (QPS)
- Zhvillimin e buxhetit, bazuar në nevojat lokale, duke u mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH);
- Raportoimin për të arriturat e objektivave të përcaktuara nga Kryetarit i Komunes dhe Kuvendi i Komunës;
- Zhvillimin, monitorimin dhe zbatimin e rregulloreve në fuqi;
- Zbatimin e normave dhe standardeve të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të miratuara nga MSH-ja;
- Mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel të komunës,
- Mbledhjen dhe analizimin e informatave në nivel lokal,
- Përcaktimit të prioriteteve lokale dhe objektivave në bazë të informatave, konform strategjisë së kujdesit parësor shëndetësor;
- Marrjes së masave për mbrojtje shëndetësore, që kanë të bëjnë me sigurimin e ujit të sigurt dhe higjienës, sigurimin e ushqimit të sigurt dhe nutricionit dhe aktivitetet e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit;
- Ndërmarrjes së fushatës sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe hartimit të marrëveshjeve me to.

Udhëzime:

- Gjatë hartimit të materialeve promovuese për shëndetin duhet të sigurohet që ato të jenë në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Çdo institucion shëndetësor duhet të kenë një tabelë orientuese të shërbimeve shëndetësore dhe të njësive brenda institucionit në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Komunikimi me pacientët, si dhe lëshimi i dokumentacionit të duhur, duhet të jetë në gjuhën amtare të pacientit (në njërën nga gjuhët zyrtare);
- Të sigurohet se të gjitha informatat në lidhje me sigurimin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore janë njëkohësisht në dispozicion për qytetarët në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të sigurohen vizita në shtëpi për pacientët në gjuhën amtare të pacientit (në njërën nga gjuhët zyrtare);
- Të sigurohet se të gjitha informatat mbi masat epidemiologjike të jenë njëkohësisht në dispozicion për të gjithë qytetarët në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar të komunave përkatëse;
- Shërbimet sociale dhe familjare për qytetarët duhet të ofrohen në gjuhën e tyre amtare (në njërën nga gjuhët zyrtare);
- Të gjitha dokumentet dhe formularët duhet të vihen në dispozicion për qytetarët në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Qytetarët duhet të informohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare mbi të gjitha masat e ndërmarra për sa i përket kujdesit shëndetësor;

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

- Informatat në lidhje me higjienën, ujin e pijshëm, të ushqyerit, deri tek aktivitetet e dezinfektimit dhe dezinfektimit duhet të vihen në dispozicion për të gjithë qytetarët në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Sektori i mirëqenies sociale

Roli dhe kompetencat e sektorit të mirëqenies sociale

- Të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- Bashkëpunimin me MSH-në, vendosja dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS-së, në nivelin lokal;
- Ndërmarrjen e masave për të identifikuar natyrën dhe nevojën për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të komunës;
- Përgatitja e planeve vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mirëmbajtjen e shënimeve të sakta statistikore.
- Koordinimit dhe mbikëqyrjes së punës së Qendrës për Punë Sociale,
- Përkujdesjes për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- Regjistrimit dhe licencimit të qendrave për përkujdesje dhe punësim,
- Pagesës së rrogave dhe trajnimit e profesionistëve të mirëqenjes sociale.

Udhëzime:

- Të gjithë formularët, deklaratat, vërtetimet dhe dokumentet e tjera duhet të vihen në dispozicion për qytetarët në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Plani dhe programi mbi mbrojtjen sociale si mënyrat e realizimit të të drejtave dhe shërbimeve duhet të publikohen në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të sigurohet komunikim dhe këshillim për qytetarët në gjuhën e tyre amtare (në njërin nga gjuhët zyrtare);
- Të sigurohet që në çdo kërkesë të qytetarëve qoftë me shkrim, me gojë, nëpërmjet telefonit apo në ndonjë formë tjetër, përgjigja të kthehet në të njëjtën gjuhë, në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Informatat në lidhje me të pastrehët të vihen në dispozicion në të gjithë territorin e komunës në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Drejtoria për Arsim

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Roli dhe kompetencat e drejtorisë

- Menaxhimi dhe koordinimi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë;
- Punësimi i mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollave në pajtueshmëri me procedurat ligjore të rekrutimit, përzgjedhja dhe punësimi i të punësuarve publikë;
- Zgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësrektorëve të institucioneve, në pajtueshmëri me procedurat ligjore për rekrutim dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT- i;
- Pagesa e stafit udhëheqës, stafit profesional dhe personelit tjetër të punësuar në institucionet arsimore të komunës;
- Mbikëqyrja e të gjitha institucioneve arsimore në nivel komune;
- Regjistrimi dhe pranimi i nxënësve, në pajtim me respektimin e parimeve të mos-diskriminimit;
- Regjistrimi i të dhënave për nxënës, sipas formularit të miratuar nga MASHT në harmoni me ligjin;
- Nxitja në barazinë e mundësisë për të ndjekur arsimin parashkollor, arsimin e obliguar, dhe atë të mesëm në komunë;
- Regjistrimi, inspektimi i shëndetit publik dhe sigurisë, si dhe licencimi i institucioneve arsimore parashkollore në pajtim me ligjin;
- Respektimi dhe afirmimi i të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre;
- Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i Rregullores së punës për shkollat, duke përfshirë Kodin e mirësjelljes për stafin udhëheqës, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit, si dhe masat disiplinore;
- Marrja e vendimeve për ankesat ndaj vendimeve drejtuese të institucioneve arsimore, të parapara me ligj;
- Nxitja e bashkëpunimit në mes mësimdhënësve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore, si dhe të institucioneve arsimore dhe familjes;
- Bashkëpunimi me drejtoritë e arsimit të komunave tjera në projekte të përbashkëta arsimore, në përdorimin e përbashkët të burimeve fizike dhe njerëzore, si dhe caktimin e fondeve për projekte dhe qëllime të tilla;
- Përcaktimi i zonave specifike të mbulimit nga shkollat në nivel komune;
- Marrja e masave për sigurimin e ambienti rrethues, urban apo rural, në të cilin është e vendosur shkolla, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt në oborrin e shkollës;
- Vlerësimi i nevojave speciale, siç përcaktohet me ligj;
- Propozimi për arsim special për nxënës dhe dhënia e vlerësimit profesional;
- Propozimi për themelimin e shërbimit këshillimor dhe shëndetësor për nevojat speciale;
- Ushtron edhe kompetenca tjera, të cilat i bartën në bazë të ligjit ose nga pushteti qendror.;

Udhëzime:

- Të publikohet në ueb faqen e komunës të gjitha ligjet që lidhen me procesin e arsimit (fillor dhe të mesëm) në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Çdo konkurs për pranimin e punëtorëve në shkollat fillore dhe të mesme duhet të publikohet në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të promovohet rëndësia mbi domethënien e mësimin të gjuhëve të komuniteteve të tjera që jetojnë në komunën përkatëse;
- Bashkëpunimi me OJQ-të me qëllim të promovimit dhe aplikimit të edukimit joformal.

Drejtoria për kulturë, rini dhe sport

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Roli dhe kompetencat e drejtorisë

- Udhëheqja me resurset kulturore lokale, duke përfshirë muzetë lokale dhe resurset e trashëgimisë kulturore;
- Bën publike shumën e buxhetit në dispozicion, për çdo vit, për përgatitjen e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë paratë e granteve që janë në dispozicion të personave të kualifikuar, si dhe përpilon rregullore për dorëzimin e aplikacioneve për grante dhe caktimin e granteve;
- Udhëheqja me Arkivin Komunal, teatrin “Dodona”, Bibliotekën e Qytetit, Stadiumin e qytetit, Palestrën e Sporteve dhe hapësirat tjera përcjellëse;
- Organizimi i shënimit të datave me rëndësi historike, kur kërkohet;
- Organizimi i debateve për zhvillim dhe avancim të kulturës, rinisë dhe sportit;
- Rishqyrtimi i raporteve kontraktuese në lidhje me objektet e kulturës, të rinisë dhe të sportit;
- Mbledhja e shënimeve faktike mbi të arriturat në kulturë, rini dhe sport;
- Bashkëpunimi i ngushtë dhe raportimi për punën e vet para Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, komitetit përkatës, kurdo që kërkohet;
- Bashkëpunimi me drejtoritë në nivel qendror nga fushëveprimtaria përkatëse, dhe këshilltarët nga këto fusha;
- Regjistrimi i grupeve, klubeve, ansambleve etj.;
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, si dhe zhvillimi i renovimit të tyre brenda territorit të komunës;
- Respektimi, përkrahja dhe ndihma për asociacione, klube dhe shoqata, dhe zbulimi i individëve me aftësi të posaçme kreative, pa bërë ndonjë dallim racor, gjinor, religjioz, nacional etj.;
- Ofrimi i institucioneve të veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtari të parësore që kryejnë ato, por në raste emergjente edhe veprimtari të tjera);
- Joshja e investitorëve dhe kërkimi i fondeve shtesë;
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t’i kenë të rinjtë.

Rekomandime:

- Të krijohen mundësitë për nxitjen e ngjarjeve kulturore që do të promovonin shumëgjuhësinë duke synuar mësimin e gjuhëve zyrtare të komunës përkatëse.

Udhëzime:

- Të sigurohet se të gjitha ngjarjet kulturore janë publikuar dhe promovuar në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha objektet që përdoren për organizimin dhe promovimin e aktiviteteve kulturore të kenë të vendosur mbishkrimin në gjuhët zyrtare;
- Fondet në dispozicion për përgatitjen e aktiviteteve kulturore dhe fondet për financimin e të njëjtave të publikohen njëkohësisht në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha njoftimet me rëndësi historike të cilatdo komunitet të botohen apo publikohen njëkohësisht në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Udhëzimet dhe formularët për regjistrimin e grupeve folklorike, ansambleve dhe shoqatave të tjera kulturore të sigurohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të informohen qytetarët në gjuhët zyrtare mbi rezultatet e bashkëpunimit me shtetet e tjera, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me mundësitë e integritit dhe shkëmbimit të përvojave;

- Të mundësohet ofrimi i mbështetjes për shoqatat, klubet dhe personat fizikë në gjuhën e tyre, nëse ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Në zbulimin e talenteve të reja të sigurohet që të gjitha komunitetet janë të mirë përfaqësuara dhe ofrimi i shërbimeve të bëhet në gjuhën e tyre amtare, në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës;
- Të gjitha dokumentet para arkivimit duhet të përkthehen në mënyrë të përshtatshme në gjuhët zyrtare të komunës.

Sektori për Rini dhe Sport

Roli dhe kompetencat e sektorit

- Krijimi i kushteve për kthimin e rinisë në vend dhe riedukimin e tyre;
- Organizimi i anketave, seminareve e trajnime të ndryshme, inkuadrimi i të rinjve kosovarë në aktualitet rinore, evropiane e botërore;
- Bën publike shumën e buxhetit në dispozicion, për çdo vit, për përgatitjen e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, duke përfshirë paratë e granteve që janë në dispozicion të personave të kualifikuar, si dhe përpilon rregullore për dorëzimin e aplikacioneve për grante dhe caktimin e granteve;
- Organizimi i debatve për zhvillim dhe avancim të rinisë, kulturës dhe sportit;
- Rishqyrtimi i raporteve kontraktuese në lidhje me objektet e kulturës, të rinisë dhe të sportit;
- Bashkëpunimi i ngushtë dhe raportimi për punën e vet para Kryetarit të Komunës, Kuvendit të Komunës, komitetit përkatës, kurdo që kërkohet;
- Bashkëpunimi me drejtoritë në nivel qendror nga fushëveprimtaria përkatëse, dhe këshilltarët nga këto fusha;
- Regjistrimi i grupeve, klubeve, ansambleve etj.;
- Mbështetja e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, si dhe zhvillimi i renovimit të tyre brenda territorit të komunës;
- Bashkëpunimi me qytete dhe shtete tjera, për të mundësuar një integrim të mirëfilltë dhe këmbim përvojash, si dhe me OJQ e organizata të tjera;
- Respektimi, përkrahja dhe ndihma për asociacione, klube dhe shoqata, dhe zbulimi i individëve me aftësi të posaçme kreative, pa bërë ndonjë dallim racor, gjinor, religjioz, nacional etj.;
- Joshja e investitorëve dhe kërkimi i fondeve shtesë;
- Kujdesja edhe për formacione të tjera nga sporti, që nuk kanë hapësirë e kushte pune;
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit në lidhje me reformat dhe kushtet që mund t'i kenë të rinjtë;

Udhëzime:

- Gjatë organizimit të seminareve, trajnimeve dhe dizajnit të sondazheve/hulumtimeve të sigurohet se njoftimi është publikuar njëkohësisht në gjuhët zyrtare si dhe në të gjitha këto aktivitete të përdoren gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Para lëshimit të fondeve në dispozicion për përgatitjen e aktiviteteve rinore dhe rregullave për dorëzimin e aplikacioneve të sigurohet se çdo gjë është e përkthyer në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse dhe që njoftimi të lëshohet në të njëjtën kohë në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Çdo debat mbi zhvillimin dhe avancimin e rinisë dhe sporteve duhet të ketë përkthim në gjuhët zyrtare, nëse palët u përkasin komuniteteve të ndryshme;
- Çdo dokument, qoftë një raport, vendim ose procesverbal, para arkivimit dhe përcjelljes për përdorim të mëtejshëm duhet të përkthehet në zyrtare;
- Çdo formular dhe thirrje për regjistrimin e klubeve sportive, grupeve dhe shoqatave të ndryshme, para publikimit dhe zbatimit duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës;
- Të mundësohet ofrimi i mbështetjes për shoqatat, klubet dhe individët (personat fizikë) në gjuhën e tyre, nëse ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës;
- Të gjitha objektet që shërbejnë për aktivitete rinore dhe sportive duhet të kenë të vendosur mbishkrime në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;

- Të gjitha njoftimet, informatat dhe dokumentet e ndërlidhura me aktivitete të rinisë dhe sportit në faqen e internetit të komunës duhet të botohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Njoftimet mbi mundësitë për shfrytëzimin e objekteve sportive dhe kulturore duhet të jenë në dispozicion për të gjitha komunitetet në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Drejtoria për financa

Roli dhe kompetencat e Drejtorisë

- Ndhmon Kryetarin e Komunës në përgatitjen e projektbuxhetit, para paraqitjes së tij në Komitetin për Politike dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës;
- Plani dinamik i realizimit të projekteve dhe alokimit të mjetëve për zërat buxhetorë;
- Planifikimi i pasqyres së rrjedhjes së parasë së gatshme;
- Ofron këshilla profesionale për organet komunale lidhur me menaxhimin e buxhetit;
- Harton projektregulloret komunale për çështje financiare;
- Udhëheqja e çështjeve financiare;
- Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare;
- Planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës, tarifën nga lëmi i tatimit në pronë, taksave dhe gjobave komunale;
- Planifikimi i të hyrave vetanake të Komunës;
- Mbajtja e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna;
- Zhvillon procedurën e eksproprijimit, shpronësimit dhe deeksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës;
- Trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

Udhëzime:

- Rregullorja për çështjet financiare para hyrjes në fuqi duhet të përkthehet në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Raporti vjetor financiar, para publikimit duhet të përkthehet në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Përcaktimi i detyrimeve dhe rregulloreve për personat juridikë dhe personat fizikë brenda territorit të komunës përkatëse duhet të jetë në dispozicion në gjuhët zyrtare;
- Para përcaktimit dhe shpalljes së lartësisë së taksave, tatimit në pronë dhe gjobave komunale gjithçka duhet të interpretohet në mënyrë identike, pa lënë mundësi për interpretim të ndryshëm, në cilëndo nga gjuhët zyrtare;
- Planifikimi dhe regjistrimi i të gjitha të ardhurave duhet të përkthehet në gjuhët zyrtare para arkivimit dhe publikimit;
- Baza e të dhënave të pronës komunale duhet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha procedurat administrative dhe dokumentacioni para hyrjes në fuqi duhet të jenë në dispozicion në të njëjtën kohë në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Sektori për ekonomi dhe zhvillim

Fushëveprimtaria e sektorit

- Në bashkëpunim me kryetarin e komunës kjo drejtori mund të përcaktojë prioritetet për investime në komunë;
- Hartimi i programeve ideore, me qëllim të zhvillimit të sektoreve primare, kontakti me institucionet e brendshme financiare siç janë bankat komerciale dhe institucionet financiare ndërkombëtare, në mënyrë që të pajiset me informacion të mjaftueshëm dhe të saktë në lidhje me kushtet e kredive (financimit) të bizneseve të ndryshme;
- Ofrimi i këshillave për biznesmenë të ndryshëm për mundësi për investime, për të orientuar kapitalin e tyre në aktivitetet produktive dhe fitimprurëse, por edhe për ata të ardhshëm;
- Basgkëpunimi dhe koordinimi i punëve për sa i përket partneritetit publiko-privat;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për mundësinë e koordinimit të punëve dhe aktivitetëve për zhvillimin ekonomik të komunës;
- Ofrimi i informatave dhe raporteve të punës, për periudha të caktuara, për efekt të punës së institucioneve komunale;
- Lëshimi i lejeve të punës për kompani/shoqëri tregtare;
- Përcaktimi i lartësisë së pagesës për lejet e punës sipas tarifave, taksave dhe gjobave komunale
- Evidentimi i ndryshimeve për lejet e punës dhe certifikatave të biznesit;
- Ofrimi i formularëve për aplikim dhe informimi i mëhershëm i bizneseve;
- Dhënia/ofrimi i informatave dhe raporteve për Drejtorinë dhe institucionet komunale;
- Ofrimi i trajnimeve profesionale në fushën e biznesit;
- Ofrimi i të dhënave Ministrive përkatëse, sipas kërkesave të tyre;

Udhëzime:

- Të sigurohet dhe të publikohet njëkohësisht në të gjitha gjuhët zyrtare përcaktimi i prioritetëve investuese;
- Të gjitha informatat mbi zhvillimin e sektorit primar, kushteve dhe modaliteteve të kreditimit të biznesit duhet të vihen në dispozicion për të gjithë qytetarët në të gjitha gjuhët zyrtare. Në asnjë mënyrë të mos publikohen në vetëm një të gjuhë, derisa nuk përkthehen edhe në gjuhët e tjera zyrtare të komunës përkatëse, por të gjitha të dhënat duhet të shpërndahen në të njëjtën kohë;
- Të gjitha subjekteve juridike dhe qytetarëve tu sigurohen këshilla të mjaftueshme në lidhje me biznesin e tyre në gjuhën e tyre amtare në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Informatat në lidhje me punën dhe aktivitetet që lidhen me zhvillimin ekonomik të komunës përkatëse duhet të jenë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare, qoftë ajo një partneritet private apo ndonjë tjetër;
- Lëshimi i licencave për shoqëritë tregtare duhet të jetë në përputhje me ligjin për gjuhët që do të thotë të jetë në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha informatat mbi mundësitë e marrjes së licencave, tarifave të caktuara, taksave dhe gjobave duhet të vihen në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha certifikatat e lëshuara mbi punën e subjekteve ekonomike në komunë duhet të jenë në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Mundësitë për aplikim të subjekteve ekonomike dhe formularët duhet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare në të njëjtën kohë për të gjithë qytetarët e komunës përkatëse;

- Informatat për trajnimet për inicimin dhe zhvillimin e bizneseve duhet të jenë të arritshme për të gjithë qytetarët në gjuhët zyrtare;
- Trajnimet për nisjen dhe zhvillimin e bizneseve duhet të sigurojnë përkthim adekuat në gjuhët zyrtare;
- Plani strategjik për zhvillim ekonomik, duke përfshirë aspektet afatshkurtëra dhe afatgjata duhet të jetë në dispozicion në gjuhët zyrtare në të njëjtën kohë dhe të jetë identik në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha subjekteve juridike dhe qytetarëve tu ofrohen këshilla të mjaftueshme në lidhje me bizneset e tyre në gjuhën e tyre amtare në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare.

Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Fushëveprimtaria e drejtorisë

- Harton programe, planin zhvillimor të komunës, planin zhvillimor urban, dhe planet rregulluese urbane të vendbanimeve dhe tërësive tjera;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për planifikimin hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij;
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;
- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin dhe merret me zbatimin e tyre;
- Organizon dhe cakton grupin profesional për mbikëqyrje, pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbime tjera përkatëse;
- Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;
- Përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin homogjen, rindërtimin e informacioneve kadastrale në formë digjitale, një model të sistemit të informacionit për tokën dhe pronën;
- Regjistrimin e pasurisë së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale;
- Lëshimin e certifikatave për personat që nuk kanë pronë të patundshme;;
- Angazhohet për zvogëlimin gradual të ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe zvogëlimin ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe të aktiviteteve të tjera që përbëjnë rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Harton programin dhe bën mbikëqyrjen e pamjeve të vlefshme të natyrës, propozon zonat e reja për mbrojtje, mbron dhe bën rehabilitimin e diversitetit dhe vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit;
- Bën mbikëqyrjen dhe kontrollimin e kushteve të sigurisë së jetës dhe shëndetit të njerëzve, në vendndërtim dhe rreth tij, gjatë zhvillimit të punimeve;

Udhëzime:

- Plani zhvillimor dhe urban, si dhe planet rregullative të vendbanimeve dhe të hapësirave të tjera duhet të jenë në të gjitha gjuhët zyrtare dhe si të tilla të miratohen dhe të publikohen;
- Çdo vendim dhe vërtetim mbi gjendjen e objekteve si dhe lejet për përdorimin e objekteve të përfunduara duhet të lëshohet në gjuhët zyrtare.
- Formularët për regjistrimin e pasurive të paluajtshme duhet të jenë në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Lëshimi i vërtetimeve personave që nuk kanë prona të patundshme apo ndonjë certifikatë tjetër, duhet të jetë në gjuhën amtare të qytetarit (nëse ajo gjuhë është njëra prej gjuhëve zyrtare), ose në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha masat e ndërmarra mbi mbrojtjen e mjedisit duhet të publikohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha udhëzimet, në tabelat zyrtare duhet të jenë në gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Në çdo kërkesë të qytetarëve të drejtuar në cilëndo nga gjuhët zyrtare duhet të kthehet përgjigje në të njëjtën gjuhë.

Drejtoria për bujqësi dhe pylltari

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

Fushëveprimtaria e drejtorisë

- Monitorimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore për bujqësi, lërim, blegtori, kopshtari, perime në rritje dhe bletari;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve vjetore të prodhimit dhe përcjellja e realizimit të këtyre planeve për mbjelljen e vjeshtës dhe pranverës, korrjen dhe mbledhjen e të mirave të fermerëve;
- Monitorimi i arritjeve shkencore në prodhimin e bagëtisë dhe krijimi i tabelave statistikore;
- Monitorimi i zbatimit të planeve vjetore të zhvillimit të blegtorisë dhe lërimit;
- Monitorimi dhe pjesëmarrja në zhvillimin e projekteve dhe planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve në komunë;
- Mbajtja e të dhënave për tokën papunuar, tokën e dhënë në shfrytëzim dhe tokën së cilës i është ndryshuar përdorimi i parashikuar;
- Ofrimi i të dhënave Ministrive përkatëse, sipas kërkesave të tyre;
- Ofrimi i repro-materialeve për mbjellje për fermerët në mënyrë që ata të fillojnë punën e tyre nëpërmjet bankave komerciale, tu bëhen të mundura format e kredive për nxitjen dhe përmirësimin e prodhimit blegtoral;
- Koordinimi i punëve për ndërveprim me sektorin e OJQ-ve që mbështesin aktivitetet bujqësore dhe sigurimin e bashkëpunimit të ngushtë me kooperativat bujqësore;
- Ofrimi i trajnimeve profesionale në fushën e bujqësisë;
- Koordinimi dhe monitorimi i aktiviteteve të gjuetisë;
- Dhënia e ndihmës për fermerët për organizimin e tyre më të mire, duke siguruar këshilla të ekspertëve, për tu afruar me donatorët dhe investitorët;

Udhëzime:

- Të gjitha hapat për zbatimin e politikave zhvillimore të këtij departamenti gjithashtu duhet të jenë në dispozicion të qytetarëve në gjuhët zyrtare;
- Planet vjetore dhe raportet që kanë të bëjnë me prodhimin dhe realizimin e mbjelljeve vjeshtore, korrjes dhe rendimenteve duhet të jenë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Të gjitha të dhënat statistikore duhet të vihet në dispozicion në gjuhët zyrtare para publikimit të tyre;
- Çdo ndryshim i përdorimit të tokës duhet arkivohet dhe të përcillet për përdorim të mëtejshëm, njëkohësisht në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha informatat dhe procedurat mbi kreditimin e fermerëve duhet të vihen në dispozicion për qytetarët në gjuhët zyrtare;
- Çdo mundësi e marrjes së lëndëve të para për bujqësi duhet të jetë në dispozicion në gjuhët zyrtare në të njëjtën kohë në dispozicion për të gjithë qytetarët;
- Formularët dhe vërtetimet e lëshuara nga ky department duhet të jenë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Në çdo kërkesë të qytetarëve në cilëndo nga gjuhët zyrtare përgjigjja duhet të kthehet në të njëjtën gjuhë në të cilën është dorëzuar kërkesa;
- Ofrimi i ndihmës fermerëve duhet të jetë/ofrohet në gjuhën e tyre amtare në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare;
- Informatat në lidhje me aftësimin profesional të fermerëve duhet të publikohen njëkohësisht në gjuhët zyrtare;
- Gjatë organizimit të trajnimeve dhe aftësimit profesional duhet të sigurohet përkthim adekuat në gjuhët zyrtare për të gjithë pjesëmarrësit;

Drejtoria për shërbime publike

Fushëveprimtaria e drejtorisë

- Vendos dhe monitoron ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë furnizimin me ujë, rrjetin e kanalizimit dhe të ujësjellësit, dhe trajtimin e ujërave të zeza;
- Organizon mirëmbajtjen verore dhe dimërore, pastrimin e rrugëve dhe trotuareve dhe rrugëve lokale;
- Organizon ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të gjelbra, vende publike dhe mirëmbajtjen e varrezave;
- Koordinimi i aktiviteteve dhe miratimi i veprimtarisë së transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe shoqatat e shoferëve të taksistëve individualë dhe operatorëve sipas rregullave ligjore, përcaktimin e linjave dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve;
- Bashkëpunimi me policinë me qëllim rregullimin e aspektit të komunikimit dhe rritjen e sigurisë në komunikacion, sidomos në afërsi të shkollave dhe institucioneve parashkollore;
- Kryen sinjalizimin vertikal dhe horizontal të rrugëve ekzistuese dhe rregullon komunikacionin në komunë;
- Mbyll apo bllokon rrugët për përdorim në raste të veçanta (festa publike, vepra të veçanta në interes të shtetit dhe atë komunal, etj);
- Bën furnizimin me ujë të pijshëm me serbatorë dhe rezervuarë të veçanta;
- Ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe/apo të eliminimit të qenve endacakë;
- Përgjegjëse për lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e tokës publike përpara lokaleve hoteliere;
- Përgjegjëse për ofrimin/mirëmbajtjen e ndriçimit publik, shenjave reklamuese, reklamave ndriçuese të kompanive dhe reklamave të tjera të ndryshme;
- Konsultimi me nivelin qendror për ndërtimin, riparimin ose ndryshimin shenjave të rrugëve ndërkomunale që ndikojnë në komunë;
- Bën vlerësimin e rrezikut brenda territorit të komunës nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në pajtim me ligjet në fuqi, përmes udhëzimeve administrative, dhe në bazë të vlerësimit të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
- Planifikimi dhe zbatimi i masave për mbrojtje dhe shpëtim;
- Sigurimi i mjeteve urgjente për strehim të përkohshëm në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;
- Gjatë zhvillimit të aktiviteteve bashkëpunon ngushtë me autoritetet e sigurisë të komunës, KFOR-it, policinë, FSK-në, OJQ-të, institucionet shëndetësore, ndërmarrjet publike dhe qytetarët në fushën e parandalimit të zjarrit, si dhe në rastet e fatkeqësive të tjera natyrore;

Udhëzime:

- Informatat rreth furnizimit me ujë, shërbimeve lokale, vështirësive dhe prishjeve të stabilimenteve me interes publik duhet tu ofrohen qytetarëve në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Të gjitha paralajmërimet dhe njoftimet në vende publike dhe hapësirat e gjelbëruara duhet të shkruhen në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha aktivitetet që lidhen me transportin publik të udhëtarëve dhe mallrave të publikohen në gjuhët zyrtare;
- Në gjuhët zyrtare dhe në të njëjtën kohë të publikohen të gjitha linjat e rregullta të transportit të qytetit, për të cilat është lëshuar leja/licenca nga drejtoria për shërbime publike;
- Të gjitha njoftimet dhe paralajmërimet për siguri më të mirë të trafikut të publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;

- Në rast të nevojës për furnizim me ujë të pijshëm nga një tank dhe rezorvoar të informohet publiku njëkohësisht në gjuhët zyrtare;
- Rreth rehabilitimit të qenve endacakë dhe të gjitha masat e marra në këtë drejtim të informohet publiku në gjuhët zyrtare;
- Kërkesat për dhënien e lejeve dhe shfrytëzimin e tokës publike të ofrohen në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha informatat sa i përket vlerësimeve mbi rrezikun nga fatkeqësitë natyrore të ofrohen në të gjitha gjuhët zyrtare;
- Udhëzimet mbi të gjitha masat për të siguruar mbrojtjen e qytetarëve të ofrohen në gjuhët zyrtare, në pajtim me ligjin për gjuhët;
- Njoftimet për sa i përket strehimoreve të përkohshme për shkak të rreziqeve natyrore dhe rreziqeve të tjera duhet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare;
- Informatat në lidhje me rrugët e kalueshme dhe ato të mbyllura në territorin e komunës përkatëse tu ofrohen qytetarëve në gjuhët zyrtare;
- Nëpunësit civilë gjatë kryerjes së detyrave të tyre dhe ofrimit të shërbimeve gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët duhet të ofrojnë një komunikim në gjuhën amtare të qytetarëve palë, në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;

Drejtoria e inspektionit

Fushat të cilat janë kompetencë e Drejtorisë së Inspeksionit janë:

- Inspektimi në lëmin e ndërtimit;
- Inspektimi në lëmin e tregtisë;
- Inspektimi në çështjet komunale dhe të komunikacionit;
- Inspektimi në lëmin e ambientit dhe
- Inspektimi në lëmin e sanitarisë dhe të veterinarisë.

Fushëveprimtaria e drejtorisë

- Inspektimin e ndërtimeve, instalimeve, renovimeve, zgjerimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, si dhe inspektimin e rrënimt të çfarëdo ndërtese apo strukture, përjashtuar punët e zakonshme për mirëmbajtjen e ndërtesave, për të cilat nuk nevojitet leje për ndërtim;
- Inspektimin e dokumentacionit teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve);
- Inspektimin e kushteve dhe masave të sigurisë, që kanë të bëjnë me sigurimin e objektit dhe të objekteve tjera përreth, si dhe masat për sigurinë e komunikacionit përreth këtyre objekteve;
- Të kontrollojë objektet tregtare, industriale dhe depot;
- Të kontrollojë vendet e punës dhe objektet tjera, në të cilat produktet vihen në shërbim;
- Të organizojë kontrollimin e respektimit të orarit të punës nga bizneset afariste, kontrolli mbi të dhënat e prejardhjes së mallit, kontrolli i zhigosjes së peshoreve, kontrollimi i librave tregtare të shit-blerjes;
- Të kontrollojë respektimin e obligimit të subjekteve afariste për vendosjen e mbishkrimit të firmave në lokalet e tyre;
- Të mbikëqyrë kyçjet pa leje në rrjetin e ujësjellësit publik nga ana e personave fizikë dhe juridikë, mbikëqyrjen dhe parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm për larjen e rrugëve, sipërfaqeve publike, autolarje, mbushjen e puseve, ujitjen e kopshteve etj.;
- Marrja e masave mbrojtëse për shëndetin e popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit dhe i pirjes së duhanit në vendet publike.

Udhëzime:

- Zyrtarët e kësaj drejtorie në kryerjen e inspektimeve të të gjitha llojeve të ndërtimit duhet të ofrojnë mundësinë për të komunikuar me palët në gjuhën e tyre amtare në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare;
- Gjatë kontrollit dhe miratimit të dokumentacionit teknik për ndërtimin e objekteve, lejeve ndërtimore dhe lejeve për përdorimin e objekteve duhet të pranohen kërkesat në cilëndo gjuhë në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar në komunën përkatëse dhe të kthehet përgjigjja në të njëjtën gjuhë;
- Gjatë kontrollit të masave të sigurisë në lidhje me objektet, si dhe masave të sigurisë në komunikacion në afërsi të këtyre objekteve t'i kushtohet vëmendje që të gjitha shenjat janë të vendosura në gjuhët zyrtare;
- Gjatë kontrollit të ndërtesave komerciale dhe industriale të sigurohet një komunikim me palët në gjuhën e tyre amtare, nëse ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare;
- Gjatë kontrollit të orarit të punës, të dhënave të origjinës së mallrave, kontrollit të librave tregtar dhe detyrimeve të tjera të tregtisë dhe aktiviteteve industriale të pranohen

dokumentet në cilëndo gjuhë zyrtare të komunës përkatëse dhe të sigurohet komunikim i ndërsjellë në gjuhën e palës;

- Gjatë inspektimit dhe kontrollit të keqpërdorimit të ujit të pijshëm nga personat fizikë dhe juridikë gjithsesi të sigurohet komunikim me palët në gjuhën e tyre, në qoftë se gjuha është një nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha masat e mbrojtjes nga gazrat e dëmshme, tymit të duhanit dhe pirjes së duhanit në vende publike duhet të shënohen në gjuhët zyrtare;
- Të gjitha masat e ndërmarra ndëshkuese duhet të përkthehen në gjuhët zyrtare përpara përcjelljes së tyre për proces të mëtutjeshëm;
- Të pranohen të gjitha ankesat dhe kundërshtimet në cilëndo nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse;
- Të gjitha kërkesave duhet tu jepet përgjigje në gjuhën në të cilën janë dorëzuar, në qoftë se ajo gjuhë është njëra nga gjuhët zyrtare të komunës përkatëse.

Rekomandime për institucionet qendrore

- Institucionet e nivelit qendror duhet të fuqizojnë Rrjetin për politikë gjuhësore duke përfshirë mekanizma të pavarur me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve si dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile me qëllim të përmirësimit të cilësisë së të gjitha politikave gjuhësore në secilën komunë.
- Institucionet e nivelit qendror duhet të sigurojnë më shumë fonde për Zyrën e komisionerit për gjuhët si dhe t'i ofrojnë ZKGJ-së mundësinë për të rritur numrin e personelit profesional, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe funksionalitetit në drejtim të avancimit në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- Është i nevojshëm ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, si dhe ndryshimi i udhëzimeve administrative. Me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, do të përcaktoheshin qartë masat ndëshkuese për thyerjen dhe shkeljen e ligjit, me ç'rast do të arrihej një zbatim më cilësor i Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe do të rritej kompetenca ekzekutive e Zyrës së komisionerit për gjuhët. Me anë të Udhëzimeve Administrative duhet të përcaktohet zbatimi i ligjit që do të kishte afate të përcaktuara kohore.
- Institucionet qendrore do të duhej të kenë një marrëdhënie më të mirë për sa i përket bashkëpunimit me institucionet vendore në drejtim të respektimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Para së gjithash institucionet qendrore do të duhej që në komunikim me autoritetet lokale të respektojnë gjuhët zyrtare, gjë kjo që do të kontribuonte në cilësinë e respektimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Respektimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve duhet të jetë reciprok nga të dyja nivelet.
- Është e nevojshme për të gjetur mënyra për stimulim/shpërblim në formën e granteve për pushtetin vendor të cilat respektojnë Ligjin për përdorimin e gjuhëve shumë më tepër se të tjerët. Në këtë mënyrë edhe komunat e tjera do të gjenin mënyra për të përmirësuar cilësinë e zbatimit të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve në territorin e tyre.
- Të mundësohet ofrimi i trajnimeve për përkthyesit dhe nëpunësit civilë mbi njohjen e gjuhëve zyrtare në tërë territorin e Kosovës.
- Duhet të inkurajohen dhe tu ofrohet një kompensim stimulues punonjësve që ofrojnë shërbime gjuhësore për qytetarët në gjuhën zyrtare që nuk është gjuha e tij/saj amtare;
- Të gjendet mënyra që në shkollat fillore dhe të mesme të futet mësimi i gjuhëve lokale (gjuhës joamtare). Në qoftë se nuk është e mundur të futet si lëndë e detyrueshme, mund të përfshihet si lëndë zgjedhore.
- Të përcaktohen masa të posaçme stimuluese fakulteteve në Kosovë të cilat formojnë katedrat për studentët e komuniteteve të tjera në gjuhën e tyre amtare.

Rekomandime për zyrën e komisionerit për gjuhët

Udhëzime për zbatimin e drejtë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale

- Të rrisë monitorimin e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
- Të publikojnë të gjitha gjetjet dhe rezultatet e hulumtimeve me qëllim të rritjes së transparencës dhe besimit të qytetarëve;
- ZKGJ-ja të organizojë takime të rregullta me komunitetet, në mënyrë që qytetarët të njihen me punën e Zyrës së komisionerit për gjuhët, si dhe të mbledhen informata mbi problemet dhe vështirësitë e qytetarëve, kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtës për të përdorur gjuhën amtare e që është njëra nga gjuhët zyrtare;
- Zyra e Komisionerit për Gjuhët duhet të punojë drejt promovimit më të madh të punës së tyre në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për mundësitë e realizimit të të drejtave të tyre;
- Në çdo institucion, të vendosen në një vend të dukshëm udhëzimet për ankesa, në mënyrë që qytetarët të mund të ankohen në qoftë se ata mendojnë se janë kërcënuar apo shkelur të drejtat e tyre gjuhësore;
- Të vendoset një bashkëpunim më i madh me organizatat e shoqërisë civile të cilat mund të jenë një urë në mes të qytetarëve dhe Zyrës së Komisionerit për Gjuhët, me qëllim të përmirësimit të zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Rekomandime për bashkësinë ndërkombëtare

- Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e Kosovës të ndihmojnë në organizimin e kurseve të gjuhës për të gjithë qytetarët, sidomos për punonjësit, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejt ofrojnë shërbime për qytetarët;
- Me anë të granteve të nxisin apo stimulojnë institucionet vendore me qëllim të zbatimit të plotë të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve;
- Të ofrojnë mbështetje për institucionet lokale dhe qendrore në kapërcimin e problemeve të evidentuara në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve nëpërmjet mekanizmit që do të përbëhej nga përkthyesit dhe lektorët;
- Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e Kosovës të mbështesin shkëmbimin e praktikave të mira me vendet që kanë përvoja me sisteme shumë gjuhësore;
- Të ofrojnë më shumë fonde për organizatat e shoqërisë civile që në mënyrë të drejtpërdrejtë merren me promovimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe promovimin e punës së Zyrës së Komisionerit për Gjuhët.

Gjuha ime, e drejta ime, mundësia ime

Kur të kalojnë ditët shkollore kur mësohet se si shkruhen gjërat, ku duhet të vendoset shkronjë e vogël dhe ku e madhe, ku vendoset pikë, presje dhe shenjat e tjera të pikësimit, gjuha edhe më tej, duhet. Përveç kësaj, fleksibiliteti, mundësitë për zhvillim, kompleksiteti hapin horizonte dhe japin hapësirë për të operuar me gjuhën. Gjuha mëson njerëzit të respektojnë gjuhë dhe alfabete të tjera dhe me këtë të rrit ndjenjën për të dashur dhe respektuar njerëz që flasin gjuhë të tjera.

Shpeshherë gjatë të shkruarit vijmë në dilemë se si shkruhet një fjalë apo thjeshtë ngatërrohemi tek radhitja e strukturave të përgjithshme të fjalive. Të tjerët, ekspertët gjuhësor, janë kujdesur për shqetësimet apo konfuzionet tona dhe në këtë mënyrë është krijuar ortografia apo drejtshkrimi i gjuhës. Drejtëshkrimi është ndihmesë e secilit që komunikon me tjetrin, sidomos në formën e shkruar dhe udhëzuesi para jush, paraqet një kombinim të shkëlqyer të të dyjave.

Për çfarë arsye gjuha na është edhe më tej e rëndësishme? Gjuha i jep formë vetëdijes, gjuha krijon mendimet dhe qëndrimet, nëpërmjet gjuhës i bëjmë më të dukshëm njerëzit, ngjarjet dhe dukuritë. Prandaj, për të gjithë ne është shumë e rëndësishme që të mund të praktikojmë gjuhën amtare në çdo mënyrë dhe në çdo situatë. Kjo nuk është vetëm një çështje e principeve të gjuhësisë dhe drejtshkrimit dhe respektimit të tyre, kjo është një çështje më shumë e respektimit të të drejtave të njeriut dhe ruajtjes së dinjitetit të çdo qytetari apo qytetareje në Kosovë. Prandaj është nevojshme që pa kompromis të kuptohet se sa i rëndësishëm është zbatimi i duhur i Ligjit të vetëm që garanton të drejtën e përdorimit të gjuhës.

Para së gjithash, nëpërmjet të kësaj praktike do të demonstroi përfaqësimin e parimit të BARAZISË. Shmangia e diskriminimit kundër përkatësisë etnike është një parim themelor i përdorimit të Udhëzimit për zbatimin e të duhur të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e institucioneve të qeverisjes lokale në Kosovë. Doracaku/Udhëzuesi është krijuar për të këshilluar, rekomanduar dhe për të mësuar se si të respektohen të drejtat themelore të njeriut. Të gjithë ne, së bashku, duhet të insistojmë në zbatimin e Ligjit për të cilin jemi aq shumë duke folur. Ne mund ta bëjmë këtë gjë. Gjuha në këto treva po bëhet gjithnjë e më e cenueshme, veçanërisht ajo gjuhë që përdoret në institucione. Përveç arsimit të dobët, një ndikim të madh dhe të keq mbi të ka gjuha angleze e cila çdo ditë e më shumë është duke u shfaqur dhe përfshirë në gjuhën e përditshme. Në fakt, shumë fjalë janë po bëhen fjalë angleze dhe ngadalë por me siguri do të inkorporohen në gjuhën e përditshme të folur dhe të shkruar. Po e humbim gjuhën. Përdorimi i gjuhëve zyrtare në masë të madhe është shumë e rëndësishme për ruajtjen e identitetit kulturor. Kjo vlen për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Të gjitha këto janë arsye për shkak të të cilave duhet të kërkojmë zbatimin e drejtë dhe të vazhdueshëm të ligjeve që kanë të bëjnë me përdorimin zyrtar të gjuhës.

Prandaj, ne duhet të jemi të durueshëm dhe të njihemi nga afër me rregullat, në mënyrë që nëpërmjet të një organizimi të mirë të arsimojmë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve për rëndësinë e përdorimit të gjuhëve zyrtare, si një kontribut për ngritjen e cilësisë së bashkëjetesës, me qytetarët, fqinjët dhe kolegët përreth nesh.